



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201301226/5

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë që nga ana juaj të shikohet mundësia e shpejtimit të procedurës gjyqësore në gjykimin e çështjes penale ndaj të gjykuarës N. V.*

Drejtuar : **Kancelarit të Gjykatës së Lartë
Z. Rudin BAQLI**

Tiranë

I nderuar Z. Baqli,

Duke patur parasysh ngjarjen e rëndë të ndodhur me datën 12.08.2012 në fshatin Krrabë të rrethit Tiranë, ku është vrarë me armë zjarri shtetasi F.M. nga fshati Manzë i rrethit Durrës dhe se për këtë vrasje është arrestuar dhe dënuar me 10 vjet burgim shtetësja N. V., duke patur parasysh shkaqet kryesore të kësaj vrasje dhe problemet e dala me interes publik për mbarë opinionin shoqëror shqiptar institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar të dy gjykimet e zhvilluara ndaj saj në Gjykatën e Shkallës Parë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ndaj këtyre dy vendimeve gjyqësore ka ushtruar rekurs e gjykuara N. V. dhe avokatët mbrojtës të saj duke kërkuar nga Gjykata e Lartë ndryshimin ose prishjen e vendimeve gjyqësore dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkaqet e parashtrruara me shkrim në rekurs.

Si nga deklaratimet e vet të gjykuarës N. V. ashtu dhe pretendimet e drejta të avokatëve mbrojtës deklarohet se vendimet gjyqësore janë të padrejta dhe të pa bazuar në ligj, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë pretendimet e ngritura se të gjykuarën N. V. qysh në moshën 14 vjeç e ka dhunuar dhe përdhunuar viktimë F. M. duke kryer me të në mënyrë sistematike mardhënie seksuale me dhunë. Jo vetëm kaq por viktimë F.M. ka ndërhyrë duke prishur edhe fejesën e saj me shtetasin S. Fj. i cili punonte si emigrant në Itali, se viktimë e ka marrë me mashtrim të gjykuarën N. V. nga data 23.05.2012 duke e mbajtur rreth 10 ditë pa ushqim në makinën e tij në pyjet e Martaneshit duke kryer me të marrdhënie seksuale dhe duke vendosur edhe prishjen e fejesës së saj.

E ndodhur çështja në këto kushte dhe rrethana mendojmë se ka vend që të gjykuarës N. V. t'i kryhet një akt ekspertim psiatrικό ligjor për të kontrolluar gjendjen psikologjike që ka qënë e gjykuara në momentin e kryerjes së krimit

të vrasjes së viktimës F. M., i cili ka shkuar në fshatin Krrabë për ta rrëmbyer përsëri të gjykuarën N. V.

Në rastin konkret mendojmë se duke kryer një akt ekspertim me grup ekspertësh kompetent mund të arrihet në një konkluzionin më të drejtë se e gjykuara ka kryer krimin e parashikuar nga neni 82 i K.Penal, vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës dhe jo krimin e vrasjes me dashje me paramendim të parashikuar nga neni 78/1 i K.Penal, që kanë vendosur në rastin konkret të dy gjykatat.

Rezultoi se nga data 12.08.2012 deri me datën 19.11.2013 kur është paraqitur rekursi për gjykim në Gjykatën e Lartë ka kaluar një kohë e gjatë dhe me këtë rast kërkojmë që të shikohet nga ana e juaj mundësia e shpejtimit të këtij gjykimi duke patur parasysh edhe kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 6 të Konventës Europian për të Drejtat e Njeriut, për një gjykim të drejtë dhe publik dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Sa sipër dhe duke u bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", dhe në nenin 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi epror i organit që ka kryer shkeljen", dhe në nenin 25 i Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në të cilin përcaktohet se: "Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, si dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Sa më sipër, Ju

R e k o m a n d o j m ë :

1. Të shikohet mundësia e shpejtimit të procedurave gjyqësore në gjykimin nga Gjykata e Lartë të çështjes penale me Nr.01588 akti, datë 06.12.2013 me të gjykuar N. V.

2. Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me urdhër dhe me Porosi

ND/KOMISIONERI

Frederik PASKALI